



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:267885

Datë: 25.03.2024

Numri i dokumentit: 05500005

KF.nr.272/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal, me gjyqtarin Fisnik NULI, dhe me zyrtaren ligjore Amire Jahire në kontestin tregtar administrativ të paditësit N.T.P “Britkos” me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N.A., kundër të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me padinë e paditësit për anulimin e vendimi, objekt kontesti vlerësim tatimor, në seancën e shqyrtimit gjyqësor kryesor-publik të mbajtur në prani të përfaqësuesit të autorizuar të paditësit N.A., e në mungesë të palës së paditur, me datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET kërkesëpadia e paditësit N.T.P “Britkos” me seli në Prishtinë, si e pa bazuar.
- II. MBETËT NË FUQI vendimi nr.443/2021, i datës 02.11.2021, i Administratës Tatimore të Kosovës me seli në Prishtinë.
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi N.T.P “Britkos” me seli në Prishtinë, me padinë e paraqitur në Gjykatë me datë 30.11.2021, ka iniciuar kontestin tregtar - administrativ kundër vendimit nr. 443/2021, i datës 02.11.2021 të paditurit Administrata Tatimore e Kosovës me seli në Prishtinë. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor- kryesor dhe në fjalë përfundimtare përfaqësuesi i autorizuar i palës paditëse ka deklaruar se: Qëndroj mbrapa ankesës që e kam parashtruar në lidhje me këtë çështje, po ashtu në këtë seancë gjykatës ia paraqes në kopje të mjaftueshme edhe një draft raport të bërë nga e paditura për një kompani tjetër, në të cilën në pikën 8, paragrafi i fundit i rekomandohet tatim paguesit që të aplikoj çmimet shitëse në harmoni me vlerën e tregut në kushte të njëjta. Prandaj ne theksojmë se e nderuara inspektore e cila ka qenë e ngarkuar për kontrollin në kompaninë tonë nuk i është përmbajtur udhëzimeve sipas nenit 24 të ligjit 05/L-037 për TVSH-ë. Vlen të theksohet se referencat e marra nga e paditura për çmimet e shitjes me pakicë respektivisht subjektet në të cilat është bazuar e paditura nuk janë të nivelit të njëjtë tregtar me këtu paditësin.

Nuk kam propozime të tjera dhe i kërkoj gjykatës që të vendos vetëm mbi bazë të provave që i ka në dispozicion në shkresat e lëndës. Kërkoj që të aprovohet padia si e bazuar, të anulohet vendimi kontestues 443/2021, dhe të kthehen mjetet e ngarkuara me raport të kontrollit. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

E paditura, në përgjigjen në padi të datës 14.03.2023, ka theksuar se i kundërshton në tërësi pretendimet e paraqitura në padi si të pa bazuara në ligj dhe fakte materiale, dhe vlerëson se vendimi i DA të ATK-së, si palë e paditur në këtë konflikt administrativ është i bazuar në ligj. Sa i përket pretendimet se ATK pa mbështetje ligjore ka ngarkuar tatim paguesin me TVSH shtesë, ATK vlerëson se kontrolli është kryer në përputhje me procedurat administrative tatimore duke u bazuar në Ligjin nr.03/L-222 për Administratën Tatimore dhe Procedurat. E paditura, në seancën e shqyrtimit gjyqësor, edhe pse është ftuar në mënyrë të rregullt dhe ka pranuar ftesën për këtë seancë me datë 20.02.2024, nuk ka prezantuar duke e njoftuar Gjykatën me parashtresën e datës 01.03.2024, se nuk do prezantoj në seancë dhe njëherit ka kërkuar nga Gjykata të vepohet në pajtim me nenin 38, par 5 të Ligjit nr.03/L-202 për Konfliktin Administrative, andaj Gjykata konform nenit 41 të LKA-së, e ka proceduar çështjen duke i lexuar parashtresat e të paditurës. Gjithashtu ka kërkuar që të refuzohet padia e paditësit në tërësi si e pa bazuar dhe të mbetet në fuqi Vendimi nr. 443/2021 i datës 02.11.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës. Shpenzimet e procedurës nuk i kërkon.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, Gjykata në procedurën e provave të shqyrtimit kryesor-publik të datës 12.03.2024, ka administruar provat dhe atë: Vendimi 443/2021 i datës 02.11.2021, të dhënat e datës 25.01.2019 nga DPT Tina 7 Prishtinë, DPT Fjona, NTP Beni, përgjigja në padi e datës 14.03.2023, forma për vizitat përmbushëse e datës 01.2019, raporti ditor fiskal X.nr.0439, formulari i deklarimit të TVSH-ës, tabela me shitje sipas artikujve për periudhën 01.01.2017-31.12.2017 nga Jora Center SH.P.K., raporti i kontrollës nr.377 i datës 05.02.2019, vendimi 0195/2019 i datës 14.02.2019, draft raporti i kontrollit i datës 04.12.2018 për subjektin German Tobacco SH.P.K.

Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues, thëniet në padi, përgjigje në padi, shkresave të lëndës në këtë kontest tregtar - administrativ, bëri ballafaqimin e provave që kanë ofruar të dy palët, dhe bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur edhe në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK-së), dhe arriti në përfundimin se në këtë kontest tregtar - administrativ, duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, për këto arsye:

Nga ekzaminimi i vendimit kontestues, Gjykata konstaton se e paditura Divizioni i Ankesave i ATK-së, e ka refuzuar ankesën e subjektit në procedurë, duke konstatuar se bazuar në shkresat e lëndës si në raportin e kontrollit, fletat e punës dhe nga informatat e palëve të treta në marra nga kontrolli-që sipas Divizionit të Ankesave vlerësohen prova relevante në marrjen e këtij vendimi dhe sipas kontrollit gjatë analizimit materiale të shitjet me kupon fiskal ka bërë nën vlerësim të çmimit të shitës. Bazuar në informatat e palëve të treta-gjegjësisht nga bizneset me veprimtari të njëjtë si: Fiona-600253207, Beni-600432489 dhe Jora Center, kontrolli për vlerësim të vlerës së tregut është bazuar në çmimet shitëse mesatare në informatat e siguruar nga palët e treta për aplikim të vlerës së hapur të tregut, për shitjet me pakicë të duhanit të llojeve “Prestigj dhe Eva Slims” pasi këto dy lloj duhani tek ky biznes marrin pjesë në blerje totale me 97.98% dhe ka nxjerrë çmimin mesatar për këtë lloj të duhanit dhe ka ngritur marzhën mesatare. Kjo mesatare e konstatuar nga kontrolli është aplikuar në sasinë e duhanit të shitur me kuponët fiskal dhe se çmimet janë marr nga çmimet e shitjes nga bizneset që bëjnë shitje për klient të fundit dhe nga mesatarja e nxjerrë me kontroll ka rezultuar qarkullimi dhe tatimi shtesë për periudhat 01/2016-07/2018 për TVSH-ë dhe TAK-ë 2016-2017.

Nga kjo gjendje faktike, Gjykata ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentojë me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata ka shqyrtuar ligjshmërinë e aktit administrativ brenda kufijve të kërkesëpadisë, në vështirësi të nenit 44 të LKA-së. Gjykata nuk ka mundur t’i merr për bazë pretendimet e paditësit të shprehura në padi dhe gjatë shqyrtimit kryesor sepse të njëjtat janë në kundërshtim me gjendjen faktike të vërtetuar nga ana e organit të paditur, në kundërshtim me provat në shkresat e lëndës dhe me dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata e vlerësoj si të pa bazuar pretendimin e paditësit se e paditura për çmimet e shitjes me pakicë respektivisht subjektet në të cilat është bazuar e paditura nuk janë të nivelit të njëjtë tregtar me paditësin, sepse çmimet janë marr nga çmimet e shitjes nga subjektet tatimore që bëjnë shitjen për konsumatorin e fundit, në përputhje me nenin 24.2 i Ligjit nr.03L-146 për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Gjithashtu aplikimi i metodave indirekte të kontrollit është mbështetur në UA nr.15/2010, respektivisht nen 30, citojmë “*Sikurse është parashikuar në paragrafin 3 të nenit 19 të ligjit, kur ekzistojnë rrethanat që e bëjnë të vështirë përcaktimin e një detyrimi tatimor për shkak të mungesës së regjistrimeve, regjistrimeve false, apo arsye të ngjashme, ATK mund të përdorë metoda indirekte, të cilat janë të përshtatshme për llogaritjen e*

detyrimit tatimor të tatim paguesit. Këto metoda mund të përdoren në rast kur nuk janë dorëzuar deklaratat, si dhe në rastet të cilat ka dyshim se nuk ka saktësi të detyrimit tatim të deklaruar”

Si rezultat, Gjykata konsideron se paditësi në këtë kontest tregtar-administrative ka dështuar që të prezantojë provat me të cilat do të mbështet pretendimet e tija në padi, për arsye se është obligim i palës paditëse që të prezantojë para Gjykatës faktet me të cilat e mbështet kërkesën e tij, si dhe një përmbledhje të arsyetimit ligjor dhe faktik të padisë, ashtu siç parashihet me dispozita ligjore.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo Gjykatë, duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Gjykata konstaton se në këtë çështje administrative, drejtë është vërtetuar gjendja faktike nga e cila del se nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, andaj pretendimet e paditësit nuk i aprovoi, sepse i vlerësoi pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga ana e organit të paditur. Andaj, mbi këtë gjendje të fakteve shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, Gjykata konstaton se vendimi nr.443/2021 i datës 02.11.2021 i Administratës Tatimore të Kosovës në Prishtinë, me të cilin është refuzuar si e pa bazuar ankesa e subjektit në procedurë, është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Gjykata për shpenzimet e procedurës vendosi në pajtim me nenin 64 të LKA-së.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, Gjykata konform dispozitave ligjore të nenit 43, par 1, dhe 46, par 1 dhe 2, të LKA-së, Ligji nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e shkallës së parë, Departamenti Fiskal

KF.nr.272/22 datë 12.03.2024

Zyrtare Ligjore

Amire Jahiri

Gj y q t a r i

Fisnik NULI

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa, në afat prej 15 ditësh nga marrja e të njëjtit, dhomave të shkallës së dytë, përmes dhomave të shkallës së parë të kësaj gjykate.